KËRKESË
Nr. 37/9, datë 14.6.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimet shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimeve (KUZ) nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., lagjja 'Mbrostar', Fier".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 202,878 (dyqind e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMEVE (KUZ) NGA UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA LAGJJA 'MBROSTAR', FIER"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip. Totale m²	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lek/m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Urani Prifti	8533	13/66	Truall		18,4	11.026	**202,878**	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale				**-**	**18,4**		**202,878**	

Shënim.
1. Për tokën "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".